

08-1766/3
31 01 20
-3-



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/ Disiplinska Komisija/ The Disiplinary Comitee

Nr.38/2019

Komisioni Disiplinor për Përmbauesit Privat, në përbërje të Alajdin Tërshnjaku kryesues, Arton Fazliu dhe Fadil I. Hoxha anëtar, procesmbajtëse Fazile Musliu, në çështjen juridiko-disiplinore ndaj organit përmbaues-përmbauesit privat [redacted] i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në [redacted] i dyshuar për shkelje disiplinore për shkak të ngritjes së vlerës për shumën 464.80€ dhe kërkesës për pagesë të vlerës shtesë në shumën 2,000.00€, pas përfundimit të seancës dëgjimore të dt:16.10.2019, në të cilën seancë prezent kanë qenë: përfaqësuesja e autorizuar e Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira Fadilete Hoxha Udhëheqëse e Lartë në Divizionin për Noterinë dhe Përmbauesit Privat në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, organi përmbaues-përmbauesi privat [redacted] në cilësinë e të dyshuarit për shkelje disiplinore, si dhe pala ankuese [redacted], në seancën e këshillimit dhe votimit të dt:16.10.2019 me shumicë votash mori kete:

V E N D I M

I.Organi përmbaues-përmbauesi privat [redacted] i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në [redacted], është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 47 par.2, neni 65 par.1.1.3, neni 339 par.1, neni 365 par.1, neni 367 par.1 pika 1.1 dhe 1.2 të LPP-së, si dhe nga neni 2 par.1, 3, 4 dhe 9 Kodit të Përkohshëm të Etikës së Përmbauesëve Privat MD-nr.07/2014.

II.Për shkeljen disiplinore të kryer, Organit përmbaues-përmbauesit privat [redacted] emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në [redacted] i shqiptohet masa disiplinore [redacted] në bazë të nenit 368 par.1.2 dhe gjobë në të holla në shumën 3,000.00€ në bazë të nenit 368 par.1.3 të LPP-së.

III. Organi përmbaues-përmbauesi privat [redacted] i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në [redacted] detyrohet që gjobën në të holla si në pikën dy në shumën 3,000.00€ në emër të masës disiplinore, t'a paguaj në llogari të buxhetit të Republikës së Kosovës bazuar në par.3 të nenit 368 të LPP.

A r s y e t i m

Ministria e Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat me dt:02.08.2019 ka paraqitur nronozim për fillimin e procedurës disiplinore, ndaj Organit përmbarrues-përmbarruesi privat [REDAKTUAR] i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDAKTUAR], si i dyshuar për shkelje disiplinore për shkak të ngritjes së vlerës për shumën 464.80€ dhe kërkesës për pagesë të vlerës shtesë në shumën 2,000.00€.

Komisioni, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, në seancën dëgjimore ka bërë shqyrtimin e provave përmes leximit dhe marrjes në pyetje në pajtim me nenin 7 par.5 të UA.MD.nr.09/2014.

Në seancën dëgjimore të mbajtur me dt:16.10.2019 në hapësirat e Ministrisë së Drejtësisë, kryesuesi i komisionit para se përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë si propozues për fillimin e procedurës disiplinore t'i ipet mundësia për shtjellimin e propozimit dhe provave, përmbarruesit privat i ka dhënë mundësinë e deklarimit lidhur me përgjegjësinë disiplinore në pajtim me nenin 7 par.3 UA.MD.nr.9/14 për Procedurën Disiplinore ndaj Përmbarruesit Privat, me ç'rast përmbarruesi ka deklaruar se nuk e ndien vehten përgjegjëse për shkelje disiplinore.

Pasi që përmbarruesi privat nuk e ka pranuar përgjegjësinë disiplinore për shkeljet e pretenduara, fjala i është dhënë përfaqësueses së MD-DNPP-së e cila ka bërë shtjellimin e propozimit dhe provave, duke deklaruar gjithnji sipas propozimit për fillimin e procedurës disiplinore të palës ankuese se, përmbarruesi privat me dashje ka bërë shkelje duke ngritur lartësinë e shumës prej 464.80€, si dhe shkeljen e dytë ku kërkon që vlera prej 2,000.00€ t'i bëhet pagesë shtesë kreditorit në emër të mbulimit të shpenzimeve për vajtje ardhje nga Franca ku shuma arrin në 22,751.00€, dhe pasi që pala ankuese ka qenë prezent nga kryesuesi i komisionit ka kërkuar t'i ipet fjala të bëjë një shtjellim më të detajuar të rastit në fjalë.

Pala ankuese, sikurse në propozimin për fillimin e procedurës disiplinore edhe në seancën dëgjimore ka deklaruar se: kërkoj të më rimbursohet vlera për të cilën jam dëmtuar në shumën 464.80, si dhe fitimin e humbur sepse ka një vit e diçka që unë vrapoj pas këtyre. Shkelja tjetër ka të bëjë se mjetet në shumën 2,000.00€ janë dhënë nën presion për me vendos a me kry problemin a mos me kry, të cilën pa dashje është dashur me pranuar sepse kam qenë me qera, kam dashtë me kry këtë problem njëherë e mirë dhe, në një farë forme rashë viktimë. Në vazhdim ka shtuar se, është i irrituar me arrogancën e përmbarruesit privat sepse, ka qenë shumë herë në zyrën e përmbarruesit privat, nuk jam unë ai që thotë përmbarruesi privat se jam i rrezikshëm e ku ta di unë, jo unë jam një qytetar i thjeshtë. Sa i përket pagesës shtesë në shumën 2,000.00€ ka sqaruar se, kreditorja e përmbarrimit i ka thënë mua duhet me mi dhënë 2,000.00€ ashtu sikurse kemi biseduar për shpenzimet e mia për ardhje dhe shkuarje nga/në Francë por, unë (pala ankuese-debitori i përmbarrimit) i kam thënë se ne nuk po më kujtohet se kemi biseduar për një gjë të tillë, e kam pyetur kreditorin se a kemi ndonjë gjë në të shkruar, i thash se unë borxhin e kam pranuar për shumën 19,000.00€ për çka kam dhënë betimin e vullnetit të lirë që kreditorin i kam borxh shumën 19,000.00€, përmbarruesi privat me tha po e kryen një gajle të madhe, jepja 2,000.00€ le te kryhet kjo farë punë dhe nuk të dhemb më kryet, thash ok epja.

Në pyetjen e komisionit se, a keni ushtruar të drejtën e prapësimit ndaj urdhërit të përmbarruesit privat për caktimin e përmbarrimit, pala ankuese ka deklaruar se, nuk e ka pranuar kurrë urdhërin për caktimin e përmbarrimit, bile as pasqyrën e shpenzimeve, kur krejt çdo gjë është kryer i kam pranuar në email sepse, unë fillova me punue dhe llogaritë i kisha të mbyllura.

Përmbauesi privat sikurse me përgjigjen në propozimin për fillimin e procedurës disiplinore edhe në seancë dëgjimore ka deklaruar se: përmbauesi privat me dt:04.03.2016 i ka dërguar debitorit të përmbaimit urdhërin për caktimin e përmbaimit së bashku me propozimin për përmbaimit dhe dokumentin përmbaues në bazë të cilit është caktuar përmbaimit por, sipas fletëkthesës së dt:12.03.2016 adresa e debitorit të përmbaimit ka rezultuar të jetë e pasaktë sepse, debitori i përmbaimit punonte dhe jetonte jashtë vendit, me të cilin pas shumë tentimeve kemi komunikuar përmes telefonit, ku deklaroi se do të vjen në zyrën e përmbauesit privat, e pasi që debitori nuk është paraqitur sikurse ka deklaruar, përmbauesi privat ka vazhduar procedurën përmbaimore duke filluar nga bllokimi i llogarive bankare, kërkesave për asistencë Policisë së Kosovës për dalje në vendngjarje katër herë, si dhe konkluzion për shënim zyrtar në Komunën e Prishtinës ndërsa, sa i përket pretendimeve të palës ankuese lidhur me kalkulimin e vlerës, si përmbaues privat ka thënë se ka vepruar në bazë të nenit 13 par.1 dhe 2 të LPP-së dhe UA-MD.nr.06/2014, ku propozuesi paraprakisht ka për detyrë ti paguaj shpenzimet e procedurës lidhur me caktimin dhe kryerjen e përmbaimit.

Tutje ka shtuar se, në vitin 2018, në zyrën e përmbauesit privat është paraqitur debitori i përmbaimit i cili ka deklaruar se, e kam gjetur blerësin për paluajtshmërinë dhe do të bëhet pagesa e borxhit të përgjithshëm. Në bazë të kontratës për shitëblerien e paluajtshmërisë Lrn.nr 7533/18 me nr.ref.1803/18 të dt:27.04.2018, kreditori [redacted], debitori [redacted] dhe blerësi i paluajtshmërisë [redacted] janë dakorduar që të bëhet pagesa në vlerën 22,751.00€, duke përfshirë edhe shpenzimet e kreditorit për pagesën e biletave Francë-Kosovë, pasi që kreditori jeton në Francë. Përmbauesi privat ka potencuar se, nuk ka qenë prezent kur është lidhur kjo kontratë dhe, kur është bërë kalkulimi i vlerës së përgjithshme, si dhe transferi i mjeteve, pra ka thënë se kjo ka qenë marrëveshje mes kreditorit dhe debitorit, ku blerësi i ka bartë mjetet direkt tek kreditorja e përmbaimit dhe, jo në llogarinë time ndërsa, mjetet në shumën 1,090.00€ në emër të shpenzimeve të procedurës të detajizuara si në pasqyrën e shpenzimeve për veprimet e ndërmarra përmbaimore, janë bartë në llogarinë e veçantë të përmbauesit nga kreditorja e përmbaimit.

Në pyetjen e komisionit të bërë përmbauesit privat se, a i keni dorëzuar të gjitha shkresat tek sekretaria e komisionit kur u janë kërkuar dhe, në mënyrë të përsëritur disa herë se a i keni dorëzuar debitorit të përmbaimit urdhërin për caktimin e përmbaimit, propozimin për përmbaimit dhe provat tjera të bashkëngjitura ashtu sikurse obligoheni sipas dispozitave të LPP-së dhe LPK-së, përmbauesi privat ka deklaruar se: “me sa e di i kam dorëzuar krejt shkresat e lëndës në MD ndërsa, në shkresa të lëndës është dëshmia që e ka nënshkruar pala debitore që e ka pranuar urdhërin për caktimin e përmbaimit”.

Komisioni pas shqyrtimit dhe analizimit të provave përmes leximit dhe marrjes në pyetje në këtë çështje disiplinore, ka konstatuar këtë gjendje faktike: organi përmbaues-përmbauesi privat me urdhërin P.nr.23/16 të dt:04.03.2016 e ka caktuar përmbaimit në këtë çështje përmbaimore, sipas fletëdorëzimit të dorëzuar në kopje në seancën dëgjimore të mbajtur me dt:16.10.2019, nga përmbauesi privat është tentuar me dt:11-12.03.2016 të bëhet dorëzimi i urdhërit për caktimin e përmbaimit debitorit të përmbaimit por, në adresën si në propozimin për përmbaimit sipas sqarimit të shërbimit postar në këtë fletëdorëzim, debitori i përmbaimit është i panjohur rrjedhimisht, debitori i përmbaimit nuk ka qenë i njoftuar me rregull për caktimin e përmbaimit. Edhe përkundër që urdhëri për caktimin e përmbaimit nuk i është dorëzuar debitorit të përmbaimit, përmbauesi privat ka vazhduar me ndërmarrjen e veprimeve përmbaimore si mjete

të përmbarimit, në drejtim të zbatimit të përmbarimit në këtë çështje përmbarimore përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit të përmbarimit. Në vitin 2018 në zyrën e përmbaruesit privat është paraqitur debitori i përmbarimit i cilia ka deklaruar se, e ka gjetur blerësin për paluajtshmërinë dhe do të bëhet pagesa e borxhit të përgjithshëm në bazë të kontratës për shitëblerjen e paluajtshmërisë Lrp.nr.7533/18 me nr.ref.1803/18 të dt:27.04.2018 të lidhur në mes të [REDAKTUAR] si shitëse dhe [REDAKTUAR] e [REDAKTUAR] si blerës i paluajtshmërisë ashtu që sipas kesaj kontrate kreditorja dhe debitori i përmbarimit janë pajtuar që nga [REDAKTUAR] person i tretë në dobi të kreditorës së përmbarimit të bëhet pagesa në shumën 22,751.00€, në të cilën shumë janë përfshirë edhe shpenzimet e kreditorës së përmbarimit për pagesën e biletave Francë-Kosovë-Francë, pasi që kreditorja e përmbarimit jeton në Francë. Sipas transferit bankar DF-01/EF-01-42500514716 të dt:03.03.2016, nga llogaria tek NLB-Prishtina e evidentuar në emër të [REDAKTUAR] është bërë pagesa në shumën 1,090.00€ në llogarinë e veçantë të përmbaruesit privat në ProCredit Bank. Sipas urdhërpagesës ref:438051933 të dt:03.05.2018, nga llogaria e personit të tretë [REDAKTUAR] në PCB, janë transferuar mjetet në shumën 22,751.00€ në llogari të kreditorës së përmbarimit [REDAKTUAR] në PCB.

Me nenin 47 par.2 të LPP-së është përcaktuar se: "Aktvendimi për përmbarimin apo urdhri për përmbarim i dërgohet kreditorit dhe debitorit apo përfaqësuesve të tyre. Aktvendimi me të cilin hedhet poshtë apo refuzohet propozimi për përmbarim i dërgohet vetëm kreditorit".

Me nenin 65 par.1.1.3 të LPP është paraparë se procedura do të pezullohet sipas detyrës zyrtare në rrethanat: "kur adresa e debitorit e dhënë në propozimin për përmbarim vërtetohet se është e pasaktë ndërsa kreditori nuk mund të argumentojë para organit përmbarues saktësinë e adresës" ndërsa, me par.2 të njëjtit nen është rregulluar se: "Procedura e pezulluar me konkluzion nga paragrafi 1. i këtij neni mund të vazhdojë nëse kreditori në afatin prej gjashtë (6) muajsh paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, në të kundërtën procedura konsiderohet e përfunduar".

Me nenin 339 par.1 të LPP është paraparë se: "Përmbaruesi privat është përgjegjës për kryerjen e veprimeve përmbarimore në pajtim me dispozitat e këtij ligji".

Me nenin 365 par.1 të LPP është paraparë se: "Përmbaruesi privat ka përgjegjësi disiplinore nëse me veprimet e tij në ushtrimin e veprimtarisë së vetë shkel dispozitat e këtij ligji dhe të dispozitave tjera, nëse nuk i plotëson detyrimet e parapara me statut dhe me akte tjera të Odës, dhe nëse shkel prestigjin e profesionit të përmbaruesit privat".

Me nenin 367 par.1 pika 1.1 dhe 1.2 të LPP është paraparë se, shkeljet disiplinore ndër të tjera mund të jenë: "nëse përmbaruesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj; nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbaruesi privat nuk i përmbahet ligjit".

Me nenin 2 par.1 të Kodit të Përkohshëm të Etikes së Përmbaruesëve Privat është rregulluar se: "përmbaruesi privat si bartës individual i shërbimit publik e kryen shërbimin e vet me ndërgjegje, ndershëm dhe në mënyrë të paanshme në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin", me par.3 është rregulluar ashtu që: "përmbaruesi privat është i detyruar që veprimtarinë e vet ta kryej me ndërgjegje dhe detyrat e veta t'i kryejë në afatin e arsyeshëm duke respektuar personalitetin dhe të drejtat e pjesëmarrësve në procedurë dhe të personave të tretë, me par.4

është rregulluar ashtu që: "përmbaruesi privat duhet të përmbahet nga sjellja e papërshtatshme, në çdo moment të veprorë në pajtim me standardet morale të profesionit të tij dhe të mbrojtë prestigjin personal dhe profesional, si dhe prestigjin e profesionit" me par.9 është rregulluar ashtu që: "përmbaruesi privat është i detyruar që gjykatës, ministrisë kompetente, dhe organeve tjera të administratës shtetërore dhe institucioneve publike, si dhe organeve të Odës t'iu sigurojë të gjitha të dhënat për punën e vet në pajtim me ligjin dhe aktet e tjera të përgjithshme".

Komisioni, pas vlerësimit të provave të shqyrtura përmes leximit dhe marrjes në pyetje në këtë çështje disiplinore, nga gjendja e konstatuar faktike, e në bazë të dispozitave të sipërcituara, në seancën për këshillim dhe votim me votë unanime ka ardhë në përfundimin se, përmbaruesi privat është përgjegjës për shkelje disiplinore në këtë çështje përmbarimore, pasi ka gjetur se përmbaruesi privat gjatë ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore si mjete të përmbarimit nuk i është përmbajtur ligjit të procedurës përmbarimore, rrjedhimisht ka ndërmarrë veprime përmbarimore jo në përputhje me dispozitat e këtij ligji, dispozitat e të cilat e obligojnë organin përmbarues në këtë rast përmbaruesin privat që detyrimisht të veprorë ashtu sikurse ato urdhërojnë dhe, vetëm në rast se një situatë nuk është e rregulluar me dispozitat e këtij ligji si ligj special, atëherë përshtatshëm mund të aplikohen dispozitat e LPK-së në pajtim me nenin 17 të LPP-së.

Në rastin konkret përmbarimor, përmbaruesi privat ka kryer shkelje disiplinore pasi që me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore nuk i është përmbajtur ligjit, ngase në shkresat e dorëzuara tek sekretaria e komisionit nuk ka dëshmi se debitorit të përmbarimit i është dorëzuar urdhëri për caktimin e përmbarimit nga organi përmbarues-përmbaruesi privat, e gjithashtu as në seancën dëgjimore të mbajtur në hapësirat e MD-së me dt:16.10.2019, në asnjë mënyrë nuk ka arritur të dëshmojë dhe t'a bind komisionin me prova se në mënyrë të rregullt i ka dorëzuar debitorit të përmbarimit urdhërin për caktimin e përmbarimit, për pasojë debitorit të përmbarimit i është pamundësuar e drejta ligjore për ushtrimin e të drejtës së prapësimit ndaj urdhërit për caktimin e përmbarimit dhe, përkundër se debitori i përmbarimit nuk është njoftuar për caktimin e përmbarimit ndaj tij, organi përmbarues-përmbaruesi privat ka vazhduar me ndërmarrjen e veprimeve tjera në drejtim të zbatimit të përmbarimit, pa u krijuar kushtet ligjore procedurale për ndërmarrjen e atyre veprimeve në të ardhmen. Pra përmbaruesi privat në asnjë rrethanë nuk ka mundur të ndërmerr asnjë veprim përmbarimor para së debitori i përmbarimit të jetë njoftuar se ndaj tij është filluar procedurë përmbarimore në të cilën ai e ka cilësinë e debitorit të përmbarimit, e as të bëjë bllokimin e llogarive bankare të debitorit të përmbarimit, përderisa debitori i përmbarimit nuk ka qenë i njoftuar për caktimin e përmbarimit ashtu sikurse obligojnë dispozita e Ligjit të Procedurës Përmbarimore dhe Kontestimore për dërgimin e shkresave.

Me nenin 65 par.1,1,3 të LPP-së, është rregulluar se si duhet të veprohet në situatën kur adresa e debitorit të përmbarimit është e pasaktë, siç ka ndodhur në rastin konkret përmbarimor, ku sipas sqarimit në fletëdorzim përmes të cilit është tentuar me dt:11-12.03.2016 t'i dorëzohet debitorit të përmbarimit urdhëri për caktimin e përmbarimit P.nr.23/16 i dt:04.03.2016, debitori i përmbarimit në adresën si në propozimin për përmbarim ka rezultuar i panjohur. Sipas kësaj dispozite, organi përmbarues në këtë rast përmbaruesi privat është dashur të kërkojë nga kreditori i përmbarimit të argumentojë para organit përmbarues saktësinë e adresës, në të kundërtën organi përmbarues e pezullon procedurën sipas detyrës zyrtare, e nëse kreditori në afatin prej gjashtë (6) muajsh nuk paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, procedura konsiderohet e përfunduar dhe, jo të vazhdojë procedurën duke ndërmarrë veprime tjera përmbarimore pa u plotësuar kushtet për ndërmarrjen e tyre.

Sjellje në kundërshtim me parimet themelore të Kodit të Përkohshëm të Etikes së Përmbauesëve Privat paraqet edhe mos dërgimi i të gjitha shkresave të lëndës tek sekretaria e komisionit sepse, me nenin 2 par.9 të këtij kodi përmbauesi privat është i detyruar që gjykatës, ministrisë kompetente, dhe organeve tjera të administratës shtetërore dhe institucioneve publike, si dhe organeve të Odës t'iu sigurojë të gjitha të dhënat për punën e vet në pajtim me ligjin dhe aktet e tjera të përgjithshme

Komisioni, me rastin e shqiptimit të masave disiplinore ka marrë për bazë të gjitha rrethanat të cilat mund të ndikojnë në llojin e masave dhe atë posaçërisht pesha dhe pasojat e shkeljes, dëmi i shkaktuar, shkalla e përgjegjësisë dhe, ka vlerësuar se masa disiplinore vërejtje publike dhe gjobë në të holla në shumën 3,000.00€, është në proporcion me shkeljet e kryera disiplinore dhe e mjaftueshme tani për tani, për shkak se deri më tani nuk ka gjetur se përmbauesit i është shqiptuar ndonjë masë tjetër disiplinore dhe, se kjo masë do të shërbejë përmbauesit privat si organ përmbaues në këtë çështje përmbaimore, si dhe përmbauesëve të tjerë të jenë më të kujdeshëm, t'u përmbahen me përpikëri dispozitave ligjore gjatë zbatimit të përmbaimit në secilën çështje përmbaimore që do të paraqitet para tyre për përmbaimit, ashtu që përmbaimit të jetë sa më pak i dëmshëm që është e mundur për debitorët e përmbaimit.

Bazuar në nenin 47 par.2, nenin 65 par.1.1.3, neni 339 par.1, 365 par.1, 367 par.1 pika 1.1 dhe 1.2, neni 368 par.1 pika 1.2 dhe 1.3 të LPP-së, në nenin 2 par.1, 3, 4 dhe 9 Kodit të Përkohshëm të Etikes së Përmbauesëve Privat MD-nr.07/2014 dhe, mbi bazën e asaj që është thënë më lart, komisioni vendosi si në dispozitiv.

**Komisioni Disiplinor për Përmbauesit Privat
Nr.38/2019; dt:16.10.2019**

**Kryetari i Komisionit Disiplinor:
Alajdin Tërshnjaku**



Këshillë juridike: Vendimi i Komisionit Disiplinor për Përmbauesit Privat është përfundimtar. Kundër vendimit të komisionit disiplinor mund të ngritet konflikti administrativ bazuar në par.5 të nenit 374 të LPP-së.